



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**  
**KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**  
**Nr. 491, datë 21.09.2023**

**PËR**  
**RENDITJEN E KANDIDATËVE NË PROCEDURËN E LËVIZJES PARALELE NË**  
**GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**  
**ELBASAN PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 253, DATË**  
**24.05.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me datë 21.09.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe me Relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, përgatitur nga relatori i procedurës së përzgjedhjes z. Klodian Kurushi,

**V Ë R E N**

**I. TË DHËNA MBI PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES**

1. Me disa vendime të datës 24.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor (*më poshtë referuar si Këshilli*) hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 253, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.
2. Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 14.06.2023.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 253 datë 24.05.2023 (më poshtë referuar si vendimi 253/2023), kandiduan gjithsej 3(tre) kandidatë, sipas tabelës së mëposhtme:

Pozicioni	Nr	Vendimi nr. 253
1		{...} Gj.JP Korçë
2		{...} <sup>1</sup> Gj.JP Shkodër
3		{...} Gj.JP Dibër

4. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 253/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 346, datë 27.06.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, një vlerësim, si edhe ata që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë nuk është përfshirë asnjë kandidat me 2 apo 1 vlerësim sipas vendimit respektiv. Të dy kandidatët përfshihen në listën e atyre që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.
5. Në vijim, me vendimin nr. 385, datë 17.07.2023, Këshilli ka vendosur: *“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallura me vendimet nr. 253;..datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim. II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat.*
6. Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit të kandidatëve të kriterëve të mëposhtme.
- 1) **“përvojës profesionale minimale”**, sipas pikës 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“6. Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*;

<sup>1</sup> Kandidatja znj. {...} me kërkesën nr. 3919 prot., datë 12.07.2023 ka hequr dorë nga kandidimi për këtë pozicion, duke mosfilluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan për pozicionin nr. 253 për këtë kandidatë.

- 2) **“mospasjes masë disiplinore në fuqi”**, sipas pikës 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“6. Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se .....ka në fuqi një masë disiplinore”*;
- 3) **“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”**, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... transferim, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”*;
7. Kandidatët e kualifikuar sipas pozicioneve që kanë aplikuar janë:
- 7.1 Për kandidaten *znj. {...}*, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 451, datë 24.07.2023, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 248 dhe nr. 253 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- 7.2 Për kandidaten *znj. {...}*, në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit. Këshilli, me Vendimin nr. 465, datë 25.07.2023, vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 253 datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
8. Këshilli me Vendimin nr. 468, datë 25.07.2023, ka caktuar nëpërmjet shortit relatorin e përzgjedhjes për pozicionet e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan; ndër ta edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 253 datë 24.05.2023. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes u caktua kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. *Klodian Kurushi*.
9. Më datë 24.07.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75 e vijuese të Vendimit të Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, *“Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të*

*gjqytarëve*”, kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionin e lirë, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatët nuk paraqitën kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

10. Siç u parashtrua, në pikat 4-5 të këtij relacioni, kandidati i vetëm i kualifikuar për pozicionin 253/2023 i përket kategorisë së kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional. Hapat dhe kriteret për renditjen e tyre janë parashikuar në mënyrë të detajuar në seksionin Ç.1 të Kreut VI të vendimit 320/2020.
11. Pika 102 e vendimit 320/2020 parashikon se: *“Kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart.”* Për sa më lart, në respektim edhe të përfundimeve të vendimit të Këshillit nr. 346, datë 27.06.2023<sup>2</sup>, këtyre kandidateve nuk u bëhet asnjë vlerësim nga Këshilli.
12. Në zbatim të pikës 106, të Vendimit të Këshillit 320/2020, relatori ka administruar dokumentacionin përkatës për kandidatët e kualifikuar, që gjendej në dosjet e tyre personale apo në praktikën dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori ka administruar edhe certifikatat e vlerësimit të Shkollës së Magjistraturës për secilin kandidat, si edhe listën e Klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për kandidatët e diplomuar në Qershor 2020.
13. Konkretisht, lidhur me vlerësimet e Shkollës së Magjistraturës, për kandidatet u konstatua se:
  - 13.1 Kandidatja *znj. {...}* e diplomuar në vitin akademik 2019-2020 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2017 qershor 2020) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4180.49 pikësh, nga 4450 të mundshme.
  - 13.2 Kandidatja *znj. {...}* e diplomuar në vitin akademik 2019-2020 në përfundim të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2017 qershor 2020) ka marrë vlerësimin “Shumë mirë”, me një total prej 4067.20 pikësh, nga 4450 të mundshme.
14. Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë pika 8 dhe 9 e Nenit 43 të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“8. Në rastet e lëvizjes paralele në gjykatë ose prokurori të shkallës së parë, kur nuk ka kandidime, sipas pikës 7, të këtij neni, procedura e lëvizjes paralele hapet për magjistratët, të cilët nuk janë vlerësuar dy herë. Ata renditen duke u bazuar njëkohësisht: a) në rezultatin e vlerësimit etik dhe profesional përkatës; b) në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të këtij ligji. 9. Në rastet e lëvizjes paralele në gjykatë ose prokurori të shkallës së parë, kur nuk ka kandidime sipas pikës 8, të këtij neni, procedura*

---

<sup>2</sup> Znj. {...} dhe znj. {...} përfshihen në shtojcën III të këtij vendimi- kategoria e kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

*e lëvizjes paralele hapet për magjistratët, të cilët nuk janë vlerësuar ndonjëherë. Ata renditen sipas pikës 8, shkronja “b”, të këtij neni.”*

15. Po ashtu, për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të Vendimit 320/2020, dalë në zbatim të pikës 12, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “ 101. Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim.”

## **II. RENDITJA E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 253, DATË 24.05.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

16. Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 253, datë 24.05.2023, u përfshinë dy kandidatë, konkretisht: znj. {...} dhe znj. {...}. Për këto kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ato ishin kualifikuar në procedurën e lëvizjes paralele ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe nuk kishin asnjë vlerësim etike dhe profesional, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “b”, pika 8, e nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në pikën 101 të Vendimit 320/2020.
17. Për renditjen e kandidatëve, u ndoq hapi i vetëm i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 8, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin Ç.1, Kreu VI, të Vendimit 320/2020.
18. Siç u parashtrua, edhe më sipër, sipas përcaktimeve të pikës 8, të nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe pikës 101, të Vendimit 320/2020 ku parashikohet se: “Për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional ndiqet një hap, në të cilin bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara më poshtë në këtë vendim ...”.
19. Referuar kriterit të renditjejes, pra atij sipas “renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës”, për kandidatët u konstatua:
- 19.1 Për kandidaten znj. {...} a) Sipas Certifikatës së vlerësimit për periudhën 3 vjeçare Tetor 2017 - Qershor 2020, kandidatja është vlerësuar, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

19.2 Për kandidaten z. {...}

Sipas Certifikatës së vlerësimit përperiudhën 3 vjeçare Tetor 2017 - Qershor 2020, kandidatja është vlerësuar, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

20. Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas *“renditjes së të diplomuarve”*, rezultoi që kandidatja znj. {...} dhe kandidatja znj. {...}, të kenë nivelin e vlerësimit *“Shumë mirë”* në renditje. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të vlerësimit të Shkollës për kandidatët, janë identifikohet dy kandidate me rezultate të njëjta në nivelin e vlerësimit, znj. {...} dhe kandidatja znj. {...}. Për pasojë, renditja e kandidatëve nuk mund të bëhet sipas nivelin të përgjithshëm.
21. Duke vijuar me përparësitë të parashikuara nga pika 103 nuk rezulton që ndonjë prej kandidateve të ketë përvojë si gjyqtar i komanduar apo në skemën e delegimit.
22. Në pikën 105 të vendimit 320/2020 përcaktohet se: *“Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sipas pikës 103, të këtij vendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar.”*
23. Nga lista kandidatëve për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253/2023, rezulton se ato i përkasin të njëjtit vit akademikë në diplomim nga Shkolla e Magjistraturës. Dy kandidatet gjenden, në listën e Klasifikimit të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në Qershor 2020 të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës.
24. Nga listat e klasifikimit të kandidatëve magjistratë, profili gjyqtarë të përcjellë nga shkolla e Magjistraturës, për vitin qershor 2020 ka rezultuar se: i) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4180.49 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 93.94 % të pikëve totale; ii) kandidatja znj. {...} në përfundim të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës ka grumbulluar gjithsej 4067.20 pikë, nga 4450 të mundshme, duke marrë në përfundim të formimit fillestar 91.40 %, të pikëve totale.
25. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, sipas listës së klasifikimit të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 253, datë 24.05.2023, ku më lart renditet kandidatja znj. {...}, ndërsa kandidatja tjetër znj. {...} renditet pas saj.
26. Siç u argumentua më sipër, renditja bazohet në vlerësimet e marra nga kandidatët e diplomuar në raport me pikët e mundshme. Znj. {...} është vlerësuar me 93.94 % të pikëve të mundshme, ndërsa znj. {...} është vlerësuar me 91.40 %, të pikëve të mundshme. Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 253, datë 24.05.2023, rezulton si më poshtë:

1) Znj. {...};

2) Znj. {...};

27. Bazuar në sa përcaktohet në pikat 19-25, të këtij vendimit, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 26 të tij, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

28. Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 11.09.2023, sikurse përcaktohet në Seksionin DH, Kreu VI, të Vendimit 320/2020, ku pasi ka konstatuar si të plotë dokumentacionin e administruar për kandidatët në këtë procedurë përzgjedhjeje, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

### **III. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

29. Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” si dhe materialet e administruara në kuadër të procedurës së përzgjedhjes, iu nënshtruan shqyrtimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të bëra në Kreun VI, të Vendimit 320/2020.

30. Gjatë shqyrtimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi si të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar për kandidatët në funksion të procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, të Këshillit.

### **IV. KONKLUZIONI**

31. Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se ishte rasti për miratimin pa ndryshime të projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 253 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

**PËR KËTO ARSYE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”,

### **VENDOSI:**

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 253, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:
  1. Znj. {...}.
  2. Znj. {...}
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidateve znj. {...} dhe znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**